



Npi – 01/268 datë:05.09.2022

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Nenit 36 dhe 37.4 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019, Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në mbledhjen e mbajtur më: 05.09.2022, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I M B L E D H J E S Ë -II- TË KOMITETIT PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE
E mbajtur më datën: 05.09.2022 (e hënë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesja: znj.Besartë Musliu-Spahija, Anëtarët: z.Hasan Avdyli, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, znj.Arbresha Syla, përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Shqiprim Hyseni, Praktikant dhe znj.Valmira Hoxha, Praktikante. Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Komitetit znj.Besarta Musliu-Spahija, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, në vazhdim konstatoi kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes, për këtë mbledhje kemi propozuar këtë

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 08.07.2022,
2. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të KSHMS për 2022,
3. Draft-Plani i punës të KSHMS për vitin 2022
4. Të ndryshme.

Kryesuesja, znj Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, unanimisht aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 08.07.2022

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hap diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Pajtohem me procesverbalin, dhe do ta votoj.

*** Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, me 4 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja më 08.07.2022.**

Pika 2

Propozim-Vendim për caktimin e orarit të KSHMS për vitin 2022

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hap diskutimin për këtë pikë.

z.Hasan Avdyli; Unë jam që mbledhjet e KSHMS-së të mbahen, së paku një dit para mbledhjes së Kuvendit, por mirë do të ishte te jetë pesë ditë para mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, është mirë që sa më herët të mbahen për shkak se duhet të përpunohet nëse ka ndonjë Konkluzion, dhe t'i prezantohet Kuvendit.

z.Reshat Mujota; Sa po e shoh unë, datat e mbajtjes të mbledhjeve të Komiteti i kemi të gjitha para mbledhjeve të Kuvendit. Te datat e propozuara unë pajtoj, por mendoj që mbledhja e Komiteti duhet të jetë jo një ditë, por edhe pesë ditë para mbledhjes së Kuvendit. Është mirë që mbledhjet të mbahen sa më herët për arsye se nëse kemi ndonjë konkluzion nga Komiteti ai duhet të mbërrin për me u rrethuar, dhe me na ardhur në Kuvend. Për propozimin e orëve jamë pak skeptik, është pak edhe faji jon sepse jemi me vonesë, më së miri ka qenë me lanë prej orës 10:00, nëse ka mundësi, nëse nuk ka mundësi atëherë bën me lanë edhe në ora 11:00.

znj.Arbresha Sylja; Përshëndetje, së pari ju faleminderit për propozimin edhe për votimin tim që të jem pjesë e këtij Komiteti. Edhe pse unë kam dhenë dorëheqje, prej aktiviteteve politike, për shkak të aspektit profesional. Sa i përket orarit të mbledhjeve të caktimi i orës, për mua është në rregull, dhe jamë që mbledhjet të thirren para mbledhjes së Kuvendit, por jo edhe shumë ditë. Dihet nga momenti kur e marrim materialin për Kuvend, kjo për arsye që me pas mundësi me shtruar çështjen në Kuvend, ky është propozimi im.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Sa i përket orarit, mundet me na ndihmuar edhe Idajeti besoj.

z.Idajet Rexhepi, zyrtar i Kuvendit; Përshëndetje, unë thash sa i përket datave, ato janë të harmonizuara edhe me mbledhjet e Kuvendit por edhe të Komiteteve tjera, siç e ka vërejt edhe Reshati, ne e kemi pasur parasysh që datat e mbledhjeve të Komitetit të jenë para Kuvendit, duke pas parasysh edhe kohën që ne me pas mundësinë për me i përfunduar konkluzionet e Komitetit për Kuvend. Ne vetëm e kemi propozuar, ju jeni ata që mundeni me e ndryshuar.

z.Reshat Mujota; Edhe për mua nuk prish punë ora 9:00 apo 10:00 por prej orës 11:00, mendoj se nuk është mirë edhe për punët që i kemi ne, nëse janë të gjithë të pajtimit atëherë le të mbetet ora 9:00 siç tha doktoresha.

*** Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, unanimitisht vendosi që mbledhjet të mbahen në ora 09:00**

*** Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, unanimitisht miratoi Vendimin për caktimin e orarit të mbledhjeve për vitin 2022.**

Pika 3

Draft-Plani i punës të KSHMS për vitin 2022

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Kërkoj falje që plani i punës ju ka ardhur me vonesë, por besoj që do të më falni, për arsye se edhe jamë e re në këtë Komitet. Në vazhdim e hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Faliminderit Kryesuese, për dërgimin e draft-planit të punës edhe pse më ka ardhur me vonesë. Mua sot më ka ardhur, e kam shqyrtuar këtë draft të planit të punës, mendoj që Arbëresha mundet me kontribuar, është mirë me dhënë mendimin për këtë plan të punës. Një vërejtje po ta jap si Kryesuese ne kemi formuar një komision për hartimin e këtij Draft plani, nuk jena ftuar askush.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Po kemi bashkëpunuar në hartimin e këtij Draft-Plani të punës edhe me Arbëreshën.

z.Reshat Mujota; Unë jam për këtë plan, dhe do ta votoj.

Ka qenë kohë e shkurtër, dhe kanë qenë shumë tema për tu diskutuar, mendoj që ato çka janë me ligj për këtë Komitet janë të përfshira, në aspektin profesional. Kryesuesja më ka konsultuar, dua me cek prej përvoja se planet e punës ndryshojnë varësisht prej dinamikës së punëve, jemi dëshmitar që edhe pandemia i ka ndryshuar strategjitë e planeve. Mendoj për këta muajt çka kanë mbetur jemi në rregull dhe besoj që ka tema mjaftueshëm për me i diskutuar e me dhënë kontributin tonë si anëtar të Komitetit. Unë kisha kërkuar që në planin e punës të ketë edhe një pikë të ndryshme, nëse ka mundësi, nëse nuk ka mundësi ne rregull.

z.Idajet Rexhepi, zyrtar i Kuvendit; Mendoj që sipas praktikave të deritanishme nuk është profesionale me nxjerrë në planin e punës edhe përkën të ndryshme, kjo mundet me mbet si kompetencë e Kryesueses me vendos për secilën mbledhje nëse ka nevojë ose jo të propozohet edhe

kjo pikë, por të shënohet në planin e punës, nuk është e ndaluar por nuk është praktikë e mirë. Nga provoja që kamë unë nuk është vendosur në planin e punës.

z.Reshat Mujota; Ne mundemi me e futë edhe si pikë shtesë me propozim në mbledhje, pra do të jetë në rend dite por jo në planin e punës.

*** Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, unanimisht miratoi Planin e Punës për vitin 2022.**

Pika 4

Të ndryshme


Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hap diskutimin për këtë pikë.

znj.Arbresha Syla; A merr pjesë në mbledhje Drejtori i Shëndetësisë.

z.Reshat Mujota; Mundet ndoshta drejtori mos me ardhur në mbledhje.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 10:42h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Komitetit
Besartë Musliu-Spahija

B. Musliu-Spahija